UDHËZIM
Nr. 6, datë 26.2.2013

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 41, DATË 8.12.2009 "PËR PROCEDURËN E NJOHJES ZYRTARE DHE TË NJËSIMIT TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 37 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Pika 5 e udhëzimit nr. 41, datë 8.12.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për procedurën e njohjes zyrtare dhe të njësimit të diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë", të ndryshuar, numërtohet si pikë 6.

II. Pas pikës 4 të udhëzimit shtohet pika 5, më përmbajtje si më poshtë:

"5. Kriteret dhe procedura për njohjen e diplomës/certifikatës së lëshuar në përfundim të studimeve të doktoratës ose për fitimin e gradës shkencore "Doktor".

5.1. Aplikanti për njohjen e diplomës/certifikatës së lëshuar në përfundim të studimeve të doktoratës ose për fitimin e gradës shkencore "Doktor", nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, dërgon me postë, në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Një kërkesë për njohjen e diplomës për gradën shkencore të fituar, drejtuar Sektorit të Njohjes së Diplomave, ku kërkohet barasvlershmëria e diplomës së fituar në shtetin përkatës me gradën shkencore "Doktor", në Republikën e Shqipërisë.

b) Formularin e aplikimit, i cili vihet në dispozicion elektronikisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

c) Një *Curriculum Vitae*.

d) Kopje të përkthyer dhe të noterizuar të diplomës (të legalizuar në vendin ku është lëshuar) dhe suplementit të saj (nëse ka të tillë) të lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore "Doktor".

e) Një kopje të disertacionit të doktoratës.

f) Vërtetimin e lëshuar nga Biblioteka Kombëtare në Tiranë, pas dorëzimit atje të një kopjeje të disertacionit.

g) Dokument për kredite të fituara gjatë zhvillimit të programit të doktoratës (nëse ka të tilla).

h) Fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës.

i) Përmbledhje në gjuhën shqipe e punimit të disertacionit.

j) Faturën e kryerjes së pagesës prej 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekësh, në një prej llogarive bankare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të publikuara në faqen elektronike zyrtare.

5.2. Brenda 10 (dhjetë) ditësh Sektori i Njohjes së Diplomave (SENJOD) informon, me postë të zakonshme ose me postë elektronike, aplikantin për mbërritjen dhe plotësinë e dosjes. Nëse informimi bëhet me postë elektronike, duhet të konfirmohet marrja e tij nga aplikanti. Në rast se nuk konfirmohet marrja e njoftimit me postë elektronike, SENJOD informon aplikantin me postë të zakonshme për mbërritjen dhe plotësinë e dosjes.

5.3. SENJOD kryen verifikimin e dokumentacionit, të autenticitetit të diplomës/certifikatës së huaj dhe të statusit, legjitimitetit dhe akreditimit të institucionit të huaj të arsimit të lartë, që e ka lëshuar atë. Materialet shkresore, për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit.

5.4. Në rastet kur dokumenti bazë nuk është i legalizuar sipas përcaktimeve të pikës 5.1c), SENJOD kryen verifikimin e vërtetësisë së tij me postë, faks ose postë elektronike, duke iu drejtuar institucionit të huaj të arsimit të lartë, ku është kryer programi i studimit. SENJOD informon sekretariatin

e KVTA-së për verifikimin e kryer.

5.5. Verifikimi nga SENJOD i dokumentacionit të parashikuar në pikën 5.1 dhe të paraqitur nga aplikanti, përfundon jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga mbërritja e aplikimit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Kur dokumentacioni është i plotë, SENJOD ia kalon atë, bashkë me përgjigjen për autenticitetin, Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë për kryerjen e njohjes zyrtare, në mbledhjen e tij të radhës.

5.6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk mban përgjegjësi administrative për vonesa që vijnë për shkak të mungesës së përgjigjes ose të përgjigjes së vonuar nga ana e aplikantit për dorëzimin e dokumenteve plotësuese, si edhe për mungesën e përgjigjes/përgjigjes së vonuar të institucionit të huaj të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën. Aplikanti njoftohet nëpërmjet postës elektronike për këto vonesa.

5.7. Pasi KVTA të ketë bërë njohjen e diplomës/certifikatës së lëshuar për fitimin e gradës shkencore "Doktor", aplikantit i jepet vërtetimi që bazohet në vendimin e KVTA-së për njohjen dhe barasvlerësimin e diplomës së fituar jashtë vendit me gradën shkencore "Doktor". Vërtetimi i lëshohet aplikantit nga sekretariati i KVTA-së brenda 3 ditëve pune nga marrja e vendimit të KVTA-së.".

III. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë dhe sekretariati i KVTA-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj